LIGJ
Nr. 54/2016

PËR MIRATIMIN E REZOLUTAVE NR. 612, "RRITJA SELEKTIVE E KAPITALIT AKSIONAR TË AUTORIZUAR PËR TË SHTUAR ZËRIN DHE PJESËMARRJEN E VENDEVE NË ZHVILLIM DHE VENDEVE NË TRANZICION (SCI)", DHE NR. 613, "RRITJA E PËRGJITHSHME E KAPITALIT GCI", TË VITIT 2010, TË KËSHILLIT TË GUVERNATORËVE TË BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD)

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, dhe të nenit 14, të Konventës së Vjenës, "Për të drejtën e traktateve", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Neni 1

Miratohen rezolutat nr. 612, "Rritja selektive e kapitalit aksionar të autorizuar për të shtuar zërin dhe pjesëmarrjen e vendeve në zhvillim dhe vendeve në tranzicion (SCI)", dhe nr. 613, "Rritja e përgjithshme e kapitalit GCI", të vitit 2010, të Këshillit të Guvernatorëve të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD).

Neni 2

Këshilli i Ministrave përcakton me vendim rregullat dhe autoritetin kompetent për realizimin e rritjes së përgjithshme të kapitalit të Republikës së Shqipërisë në Bankën Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD).

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 19.5.2016

Shpallur me dekretin nr. 9635 , datë 13.6.2016 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
KËSHILLI I GUVERNATORËVE
REZOLUTA NR. 612

2010, RRITJA SELEKTIVE E KAPITALIT AKSIONAR TË AUTORIZUAR PËR TË SHTUAR ZËRIN DHE PJESËMARRJEN E VENDEVE NË ZHVILLIM DHE VENDEVE NË TRANZICION

Ndërsa, në takimin e tij të prillit 2010, Komiteti Ministerial i Përbashkët i Këshillit të Guverna-torëve të Bankës dhe Fondit për transferimin e burimeve reale te vendet në zhvillim, miratoi propozimet për fazën e dytë të reformave për të shtuar zërin dhe pjesëmarrjen e vendeve në zhvillim dhe tranzicion në grupin e Bankës Botë-rore;

Ndërsa në raportin e tyre, të miratuar më 20 korrik 2010, drejtorët ekzekutivë rekomandojnë se Bordi i Guvernatorëve, miraton:

a) Një rritje në gjendjen e kapitalit aksionar të autorizuar të Bankës dhe alokimin e aksioneve tek anëtarët, siç përcaktohet në pjesën A të kësaj rezolute; dhe

b) Një rishikim të pjesëmarrjes aksionare të Bankës çdo pesë vjet, duke filluar nga viti 2015, siç përcaktohet në pjesën B të kësaj rezolute; dhe

Ndërsa për arritjen e qëllimit të rritjes së veçantë në nënshkrimin e anëtarëve, drejtorët ekzekutivë kanë vërejtur se është e nevojshme që të gjithë anëtarët të heqin dorë nga e drejta e tyre sipas nenit II, seksioni

3/"c" të statutit të bankës (më poshtë i referuar si "statuti") të nënshkruar për një kuotë proporcionale të rritjes së kapitalit aksionar të autorizuar sipas kësaj rezolute.

Si rrjedhojë, me anë të kësaj rezolute, Këshilli i Guvernatorëve vendos si më poshtë:

A. Rritje në kapitalin aksionar dhe alokimin e aksioneve

1. Kapitali aksionar i autorizuar i bankës rritet me 230,374 aksione të kapitalit aksionar, ku secili ka një vlerë nominale prej $100,000 të shprehura në USD të peshës dhe përqindjes së arit në fuqi më 1 korrik 1944, siç është interpretuar nga drejtorët ekzekutivë.

2. Secili anëtar i bankës autorizohet të nënshkruajë deri në numrin total të aksioneve të vendosura përbri emrit të tij në tabelën e mëposhtme, në përputhje me kushtet e përcaktuara më poshtë në paragrafin 3.

ANËTARË	NUMRI I AKSIONEVE TË AKORDUARA		ANËTARË	NUMRI I AKSIONEVE TË AKORDUARA	
	6% PAGUAR; 94% E KËRKUESHME KOLONA 1	TËRËSISHT E KËRKUESHME KOLONA 2		6% PAGUAR; 94% E KËRKUESHME KOLONA 1	TËRËSISHT E KËRKUESHME KOLONA 2
AFGANISTAN	99	-	KOSTA RIKA	653	-
SHQIPËRI	-	107	BREGU I FILDISHTË	-	250
ANGOLA	-	250	DANIMARKË	593	-
ARGJENTINA	2,643	-	XHIBUTI	-	73
ARMENIA	-	160	EKUADOR	-	250
AUSTRALIA	467	-	EGJIPT, REPUBLIKA	1,322	-
AUSTRIA	467	-	ARABE	568	-
AZERBAJXHAN	-	225	EL SALVADOR	-	77
BANGLADESH	-	250	ERITREA	182	-
BELGJIKË	541	-	ETIOPI	467	-
BELIZE	-	84	FINLANDË	1,945	-
BENIN	-	126	FRANCË	-	70
BUTAN	-	58	GAMBIA	-	211
BOLIVI	-	239	GJEORGJI	3,812	-
BOSNJË-HERCEGOVINA	104	-	GJERMANI	-	213
BRAZIL	8,314	-	GANË	4,142	-
BURKINA FASO	-	126	GREQI	-	250
BURUNDI	-	107	GUATEMALA	-	179
KAMBOXHIA	175	-	GUINEJA	-	73
KAMERUN	-	211	GUINEA-BISAO	-	146
KANADA	1,255	-	GUAJANA	-	156
KEPI I GJELBËR	-	67	HAITI	-	86
REPUBLIKA QENDRORE	-	113	HONDURAS	467	-
ARABE	-	113	HUNGARI	117	-
ÇAD	971	-	ISLANDË	9,348	-
KILI	38,283	-	INDI	3,009	-
KINA	1,326	-	INDONEZI	3,474	-
KOLUMBI	-	45	IRAN, REPUBLIKA	-	250
KOMOROS	-	250	ISLAMIKE	874	-
KONGO, REP. DEM.	-	124	IRAK	5,215	-
KONGO, REPUBLIKA			IRLANDË		
			ITALI		

ANËTARË	NUMRI I AKSIONEVE TË AKORDUARA	
	6% PAGUAR; 94% E KËRKUESHME KOLONA (1)	TËRËSISHT E KËRKUESHME KOLONA (2)
JAPONI	3,559	-
JORDANI	-	197
KAZAKISTAN	624	-
KENIA	-	250
KIRIBATI	-	72
REPUBLIKA E	13,586	-
KORESË KOSOVË	-	143
KUVAJT	1,919	-
REPUBLIKA E	-	154
KIRGISTANIT	37	-
REP. DEM. POP. E	498	-
LAO	-	83
LIBAN	-	74
LESOTO	154	-
LIBERI	-	201
LUKSEMBURG	-	148
MADAGASKAR	-	68
MALAVI	-	156
MALDIVE	-	68
MALI	-	132
ISHUJT MARSHALL	12,562	-
MAURITANIA	-	58
MEKSIKË	-	198
MIKRONEZI, Shtetet	-	71
Federale	-	250
MOLDAVI	-	121
MONGOLI	-	250
MAROK	-	141
MOZAMBIK	663	-
M YANMAR	467	-
NEPAL	-	81
HOLANDË	-	123
ZELANDA E RE	607	-
NIKARAGUA	318	-
NIGER	-	177
NORVEGJI	-	165
PANAMA	738	-
PAPUA GUINEJA E	971	-
RE PARAGUAI	2,540	-
PERU	467	-
FILIPINE		
POLONI		
PORTUGALI		

ANËTARË	NUMRI I AKSIONEVE TË AKORDUARA	
	6% PAGUAR; 94% E KËRKUESHME KOLONA (1)	TËRËSISHT E KËRKUESHME KOLONA (2)
RUMANI	1,407	-
FEDERATA RUSE	6,651	-
RUANDA	-	139
SAMOA	-	82
SAOTOME DHE	-	61
PRINCIPE	6,651	-
ARABIA SAUDITE	-	250
SENEGAL	-	105
SIERRA LEONE	4,498	-
SINGAPOR	88	-
SLLOVENI	-	62
ISHUJT SOLOMON	-	80
SOMALI	467	-
AFRIKA JUGORE	6,851	-
SPANJË	-	250
SRI LANKA	720	-
SUDAN	-	59
SVAZILAND	677	-
SUEDI	746	-
ZVICËR	-	250
REPUBLIKA ARABE E	-	144
SIRISË	-	176
TAXHIKISTAN	2,417	-
TANZANI	-	77
TAILANDË	-	156
TIM OR-LESTE	-	62
TOGO	617	-
TONGA	11,908	-
TUNIZI	101	-
TURQI	115	-
TURKMENISTAN	1,831	-
UGANDË	1,945	-
EMIRATET E	38,459	-
BASHKUARA ARABE	-	250
MBRETËRIA E	-	84
BASHKUAR SHTETET E	2,325	-
BASHKUARA	-	250
UZBEKISTAN	-	250
VANUATU	-	250
VIETNAM		
REPUBLIKA E JEMENIT	**219,017**	**11,357**
ZAMBIA		
ZIMBABVE		
TOTALI		

3. Çdo nënshkrim i mësipërm, i autorizuar sipas paragrafit 2 kryhet në përputhje me kushtet e mëposhtme:

a) çmimi i nënshkrimit për aksion duhet të jetë nominal;

b) çdo anëtar mund të marrë pjesë në ankand për blerje aksionesh deri me numrin total që përcaktohet përbri emrit të tij në tabelën e mësipërme, në paragrafin 2, herë pas here, para përvjetorit të 4-t të datës së miratimit të kësaj rezolute ose në një datë të mëvonshme të vendosur, pasi të jetë marrë në konsideratë kërkesa e një anëtari për zgjatjen e periudhës së nënshkrimit, ku përfshihet një program që përshkruan hapat që një anëtar do të ndërmarrë për nënshkrimin e aksioneve, sidoqoftë, me kusht që:

i) zgjatja e periudhës së nënshkrimit të një anëtari deri në përvjetorin e 5-të të datës së miratimit të kësaj rezolute ose më herët vendoset sipas autoritetit të presidentit dhe një zgjatje e tillë në një datë më të vonë se sa përvjetori i 5-të nga data e miratimit të kësaj rezolute vendoset nga drejtorët ekzekutivë; dhe

ii) pavarësisht nga rrethanat, periudha e nënshkrimit nuk zgjatet pas përvjetorit të 6-të nga data e miratimit të kësaj rezolute;

c) në lidhje me çdo nënshkrim të paraqitur në paragrafin 2, kolona 1 më sipër, anëtarët nënshkrues i paguajnë bankës siç përcaktohet në nenin II, seksioni 7/"i" të statutit;

i) ar ose dollarë të Shteteve të Bashkuara, të barabartë me 0.6% (zero pikë gjashtë për qind) të çmimit të nënshkrimit të aksioneve të nënshkruara; dhe

ii) një shumë në monedhën e tij ose ndonjë monedhë tjetër të barabartë me 5.4% (pesë pikë katër për qind) të këtij çmimi të nënshkrimit.

Me kusht që, pavarësisht nga rrethanat, një monedhë e tillë:

A. Livrohet në të holla ose, në raste të shumës sipas nënparagrafit "c"/"ii" më sipër, në përputhje me paragrafin "d" më poshtë; dhe

B. Është lirisht e konvertueshme për përdo-rim në operacionet e Bankës, me përjashtim të rasteve kur anëtari ka të drejtë të marrë hua vetëm nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (më poshtë e referuar si "Shoqata") dhe jo nga Banka, duke filluar nga data 1 korrik 2010, nuk i nënshtrohet kërkesës në klauzolën B nëse monedha e atij anëtari nuk është lirisht e konvertueshme;

d) pagesat e shumave sipas paragrafit 3/"c"/"ii" më sipër mund të kryhen me anë të depozitave të bankënotave të prezantueshme që nuk gjenerojnë interes në një formë të pranueshme nga Banka dhe që ajo i konverton menjëherë në të holla, përveç rastit kur, nëse monedha denominohet në një valutë të ndryshme nga dollarët e Shteteve të Bashkuara dhe nëse shuma e bankënotave është më e vogël se sa shuma e detyruar në dollarë të Shteteve të Bashkuara në datën e konvertimit në të holla, anëtari i paguan Bankës shumën plotësuese brenda një periudhe prej 7 ditësh nga data e paraqitjes së bankënotës për konvertim në të holla, për t'u siguruar se Banka arkëton çmimin e plotë të blerjes së aksioneve të nënshkruara;

e) lidhur me çdo nënshkrim të paraqitur në paragrafin 2, kolonat 1 dhe 2 më sipër, Banka i konsideron të paguara pjesët 2% dhe 18% të nënshkrimeve sipas nenit II, seksioni 7/"i" të statutit, për të cilat nuk kërkohen pagesa sipas paragrafit 3/"c" më sipër vetëm kur nevojitet plotësimi i detyrimeve të Bankës për fonde të marra hua ose për huat e garantuara prej saj dhe jo për përdorim nga Banka për aktivitete huadhënëse ose për shpenzime administrative;

f) para se çdo nënshkrim të pranohet nga banka, anëtari duhet të ketë:

i) marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar një nënshkrim të tillë dhe duhet t'ia mundësojë Bankës një informacion të tillë nëse Banka mund ta kërkojë;

ii) kryer pagesat e përcaktuara në paragrafin 3/"c" dhe "d" më sipër; dhe

iii) marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar përdorshmërinë e pakufizuar dhe të shpejtë nga Banka në veprimet e saj në lidhje me pjesën e çmimit të nënshkrimeve/të aksioneve të paguara në monedhën e anëtarëve sipas nenit II, seksioni 7/"i" të neneve; dhe

iv) për aksionet e alokuara sipas paragrafit 2 më sipër mbi bazat e angazhimit të anëtarëve për të mundësuar kontributet e rënë dakord ndaj rimbushjes së gjashtëmbëdhjetë të burimeve të Shoqatës, anëtari fillimisht duhet t'i ketë paraqitur Shoqatës instrumentin e tij të anga-zhimit sipas rimbushjes së gjashtëmbëdhjetë në shumën e rënë dakord midis anëtarëve dhe bankës; dhe

g) me nënshkrimin e këtyre aksioneve, anëtari do të konsiderohet të ketë:

i) dhënë pëlqimin e tij të parevokueshëm të përdorimit të pakufizuar dhe të menjëhershëm të kapitalit të tij të paguar, pavarësisht të drejtave që gëzon anëtari për miratim sipas nenit IV, seksioneve 2/"a" dhe "b" të statutit, të drejtave të tjera sipas nenit V, seksionit 12 të statutit për të zëvendësuar bankënotat ose obligacionet e ngjashme ose çdo të drejtë tjetër ose kufizime; dhe

ii) pranuar se pjesa e disbursuar e nënshkrimit të tij nevojitet në veprimet e Bankës dhe bankënotat ose obligacionet mund të mos zëvendësohen me valutën e ndonjë anëtari.

4. Në mungesë të një njoftimi për Bankën nga ndonjë anëtar brenda 21 (njëzet e një) ditëve nga data e kalimit për votim të rezolutës te guvernatorët dhe që synon ushtrimin e së drejtës sipas nenit II, seksioni 3/"c" të statutit për t'u nënshkruar në kuotën e tij proporcionale të rritjes së kapitalit aksionar të autorizuar, të përcaktuar sipas kësaj rezolute, një anëtar i tillë konsiderohet se e ka humbur këtë të drejtë.

5. Të gjitha të drejtat, duke përfshirë të drejtën e votës, të kërkuara në lidhje me aksionet për të cilat është kryer pagesë me anë të bankënotës, sipas paragrafit 3/"d" më sipër duhet të pezullohet:

a) nëse pagesa nuk është kryer brenda një periudhe prej shtatë ditësh nga paraqitja e saj për t'u kthyer në të holla; dhe

b) nëse, për çdo bankënotë të denominuar në një valutë të ndryshme nga dollari i Shteteve të Bashkuara, kthimi në të holla çon në një humbje të çmimit të blerjes të aksioneve dhe pagesa shtesë nuk bëhet brenda një periudhë prej 7 ditësh të datës përkatëse të pagesës, në secilin rast vetëm për sa u përket aksioneve për

të cilat pagesa nuk është arkëtuar dhe derisa pagesa e plotë në të holla të arkëtohet nga Banka.

6. Pas përfundimit të periudhës së nën-shkrimit të përcaktuar në paragrafin 3/"b" më sipër:

a) nënshkrimi për çdo aksion për të cilin janë pezulluar të drejtat në përputhje me paragrafin 5 më sipër, bëhet i pavlefshëm; dhe

b) kapitali aksionar i alokuar Bankës që nuk është nënshkruar, duke përfshirë të gjitha aksionet për të cilat nënshkrimi është bërë i pavlefshëm sipas paragrafit 6/"a" më sipër, bëhet pjesë e kapitalit aksionar të paalokuar të Bankës.

B. Kontrolli i rregullt i pjesëmarrjes aksionare

Pjesëmarrja aksionare e Bankës duhet të kontrollohet çdo pesë vjet, duke filluar nga viti 2015.

Pjesët A dhe B të kësaj rezolute nuk hyjnë në fuqi derisa të gjithë anëtarët të kenë hequr dorë nga të drejtat e tyre sipas nenit II, seksioni 3/"c" të statutit për të nënshkruar pjesën e tyre proporcionale të rritjes së kapitalit aksionar të autorizuar të Bankës, sipas kësaj rezolute.

(Miratuar më 16 mars 2011)

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM
KËSHILLI I GUVERNATORËVE
REZOLUTA NR. 613

RRITJA E PËRGJITHSHME E KAPITALIT, 2010

Ndërsa drejtorët ekzekutivë, pasi kanë shqyrtuar çështjen e zgjerimit të burimeve të Bankës përmes një rritjeje të kapitalit të saj, të autorizuar, pasi kanë arritur në përfundimin se një rritje e tillë do të ishte e dëshirueshme dhe, në Raportin e miratuar më 20 korrik 2010 i kanë paraqitur Këshillit të Guvernatorëve një propo-zim për një rritje të tillë;

Ndërsa Drejtorët Ekzekutivë kanë propozuar që secili anëtar të autorizohet, duke iu nënshtruar kushteve të caktuara, për të nënshkruar aksione të kapitalit, të autorizuar së fundi në përpjesëtim me numrin e përgjithshëm të aksioneve që anëtari ka nënshkruar apo është i autorizuar të nënshkruajë, duke përfshirë aksione që anëtarë të caktuar janë të autorizuar të nënshkruajnë në përputhje me Rezolutën e propozuar me titull "Rritje selektive në kapitalin aksionar të autorizuar për të shtuar zërin dhe pjesëmarrjen e vendeve në zhvillim dhe tranzicion, 2010" (më poshtë e referuar si "Rezoluta e rritjes selektive të kapitalit").

Si rrjedhojë, me anë të kësaj rezolutë, Këshilli i Guvernatorëve vendosi si më poshtë:

1. Kapitali aksionar i autorizuar i Bankës do të rritet me 484,102 aksione të kapitalit aksionar, ku secili aksion ka një vlerë nominale prej $100,000, të shprehura në USD të peshës dhe përqindjes së arit në fuqi në datën 1 korrik 1944, siç është interpretuar nga drejtorët ekzekutivë.

2. Çdo anëtar i Bankës autorizohet të nënshkruajë deri në numrin e përgjithshëm të aksioneve, të përcaktuar përbri emrit të tij në tabelën e mëposhtme, në përputhje me kushtet e përcaktuara në paragrafin 3 më poshtë:

ANËTARË	NUMRI I AKSIONEVE TË ALOKUARA
AFGANISTAN	107
SHQIPËRI	250
ALGJERI	2,472
ANGOLA	782
ANTIGUA DHE BARBUDA	139
ARGJENTINA	5,564
ARMENIA	347
AUSTRALIA	6,661
AUSTRIA	3,081
AZERBAIXHAN	500
BAHAMAS,	286
BAHREIN	295
BANGLADESH	1,364
BARBADOS	253
BJELLORUSI	888
BELGJIKË	7,889
BELIZE	179
BENIN	266
BUTAN	143
BOLIVI	541
BOSNJA DHE HERCEGOVINA	174
BOTSVANA	164
BRAZIL	11,305
BRUNEI DARUSSALAM	634
BULLGARIA	1,393
BURKINA FASO	266
BURUNDI	220
KAMBOXHIA	104
KAMERUN	464
KANADA	12,304
KEPI I GJELBËR	154
REPUBLIKA QENDRORE AFRIKANE	261
ÇAD	261
KILI	2,111
KINË	22,476
KOLUMBI	2,052
KOMOROS	87
KONGO, REP. DEM.	773
KONGO, REPUBLIKA	281
KOSTA RIKA	237
BREGU I FILDISHTË	739
KROACIA	613
QIPRO	390
REPUBLIKA ÇEKE	1,685
DANIMARKË	3,752
XHIBUTI	169
DOMINIKA	135
REPUBLIKA DOMENIKANE	559
EKUADOR	807
EGJIPT, REPUBLIKA ARABE	2,252
EL SALVADOR	189
GUINEA EKUATORIALE	191
ERITREA	179
ESTONIA	247

ANËTARË	NUMRI I AKSIONEVE TË ALOKUARA
ETIOPIA	310
FIXHI	264
FINLANDË	2,412
FRANCË	19,062
GABON	264
GAMBIA	164
GJEORGJI	480
GJERMANI	20,363
GANË	464
GREQI	1,557
GRENADA	142
GUATEMALA	601
GUINEA	393
GUINEA-BISAO	164
GUAJANA	322
HAITI	327
HONDURAS	194
HUNGARI	2,276
ISLANDË	367
INDI	14,744
INDONEZI	4,856
IRAN, REPUBLIKA ISLAMIKE	7,373
IRAK	817
IRLANDË	1,642
IZRAEL	1,269
ITALI	13,362
XHAMAJKA	689
JAPONI	34,885
JORDANI	424
KAZAKISTAN	964
KENIA	724
KIRIBATI	143
REPUBLIKA E KORESË	7,912
KOSOVË	296
KUVAIT	4,097
REPUBLIKA E KIRGISTANIT	337
REP. DEM. POP. E LAO	57
LETONI	370
LIBAN	224
LESOTO	199
LIBERI	143
LIBI	2,095
LITUANIA	403
LUKSEMBURG	483
MAQEDONI, FYR	114
MADAGASKAR	434
MALAVI	332
MALAJZI	2,203
MALDIVE	143
MALI	352
MALTË	287
ISHUJT MARSHALL	143
MAURITANIA	276
MAURITIUS	332

ANËTARI	NUMRI I AKSIONEVE TË
MEKSIKË	8,459
MIKRONEZI, SHTETET FEDERALE	143
MOLDOVI	418
MONGOLI	143
MAL I ZI	184

ANËTARI	NUMRI I AKSIONEVE TË ALOKUARA
SLLOVENI	360
ISHUJT SOLOMON	154
SOMALI	169
AFRIKA JUGORE	3,760
SPANJË	9,311

MAROK	1,396
MOZAMBIK	281
MYANMAR	731
NAMIBI	407
NEPAL	296
HOLLANDË	9,663
ZELANDA E RE	2,058
NIKARAGUA	184
NIGER	261
NIGERI	3,413
NORVEGJI	2,829
OMAN	417
PAKISTAN	2,495
PALAU	4
PANAMA	188
PAPUA NEW GUINEA	393
PARAGUAJ	372
PERU	1,622
FILIPINE	2,088
POLONI	3,612
PORTUGALI	1,584
KATAR	293
RUMANI	1,448
FEDERATA RUSE	14,023
RUANDA	317
SAMOA	164
SAN MARINO	159
SAO TOME DHE PRINCIPE	149
ARABIA SAUDITE	14,023
SENEGAL	620
SERBI	760
SEYCHELLES	70
SIERRA LEONE	220
SINGAPOR	1,287
REPUBLIKA SLLOVAKE	859
SRI LANKA	1,087
ST. KITTS DHE NEVIS	73
ST. LUCIA	147
ST. VINCENT & THE GRENADINES	74
SUDAN	419
SURINAM	110
SVAZILAND	133
SUEDI	4,182
ZVICËR	7,308
REPUBLIKA ARABE E SIRISË	655
TAXHIKISTAN	322
TANZANI	393
TAILANDË	2,342
TIMOR-LESTE	159
TOGO	337
TONGA	149
TRINIDAD DHE TOBAGO	712
TUNIZI	357
TURQI	5,407
TURKMENISTAN	168
UGANDË	196
UKRAINË	2,933
EMIRATET E BASHKUARA ARABE	1,126
MBRETËRIA E BASHKUAR	19,062
SHTETET E BASHKUARA	81,074
URUGUAJ	751
UZBEKISTAN	733
VANUATU	179
VENEZUELË, REP. BOLIVARIANA DE	5,531
VIETNAM	880
REPUBLIKA E JEMENIT	658
ZAMBIA	818
ZIMBABVE	955
TOTALI	**484,102**

3. Çdo nënshkrim i autorizuar sipas paragrafit 2 më sipër, u nënshtrohet termave dhe kushteve të mëposhtëm:

a) çmimi i nënshkrimit për aksion duhet të jetë nominal;

b) çdo anëtar mund të nënshkruajë aksione deri në numrin total të përcaktuar përbri emrit të tij në tabelën e mësipërme, në paragrafin 2 herë pas here para përvjetorit të 5-të të datës së miratimit të kësaj rezolute ose në një datë të mëvonshme të vendosur pasi të jetë marrë në konsideratë kërkesa e një anëtari për zgjatjen e periudhës së nënshkrimit, ku përfshihet një program që përshkruan hapat që një anëtar do të ndërmarrë për nënshkrimin e aksioneve, sido-qoftë, me kusht që:

i) zgjatja e periudhës së nënshkrimit të një anëtari deri në përvjetorin e 6-të të datës së miratimit të kësaj rezolute ose më herët vendoset sipas autoritetit të Presidentit, dhe një zgjatje e tillë në një datë më të vonë se sa përvjetori i 6-të nga data e miratimit të kësaj rezolute vendoset nga drejtorët ekzekutivë; dhe

ii) pavarësisht nga rrethanat, periudha e nënshkrimit nuk zgjatet pas përvjetorit të 7-të nga data e miratimit të kësaj rezolute;

c) lidhur me çdo nënshkrim të paraqitur në paragrafin 2, kolona 1 më sipër, anëtarët nënshkrues i paguajnë Bankës, siç përcaktohet në nenin II, seksioni 7/"i" të statutit;

i) ar ose dollarë të Shteteve të Bashkuara, të barabartë me 0.6% (zero pikë gjashtë për qind) të çmimit të nënshkrimit të aksioneve të nën-shkruara; dhe

ii) një shumë në monedhën e tij ose ndonjë monedhë tjetër të barabartë me 5.4 % (pesë pikë katër për qind) të këtij çmimi të nënshkrimit,

me kusht që, pavarësisht nga rrethanat, një monedhë e tillë: A. Livrohet në të holla ose, në raste të shumës sipas nënparagrafit "c"/"ii" më sipër, në përputhje me paragrafin "d" më poshtë; dhe B. Është lirisht e konvertueshme për përdorim në operacionet e Bankës, përjashtuar rastet kur anëtari ka të drejtë të marrë hua vetëm nga Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (më poshtë e referuar si "Shoqata") dhe jo nga Banka, duke filluar nga data 1 korrik 2010, nuk i nënshtrohet kërkesës në klauzolën B nëse monedha e atij anëtari nuk është lirisht e konvertueshme;

d) pagesat e shumave sipas paragrafit 3/"c"/"ii" më sipër mund të bëhen me anë të depozitave të bankënotave të prezantueshme që nuk krijojnë interes në një formë të pranueshme nga Banka dhe që ajo i konverton menjëherë në të holla, përveç rastit kur, nëse monedha denominohet në një valutë të ndryshme nga dollarët e Shteteve të Bashkuara dhe nëse shuma e bankënotave është më e vogël se sa shuma e detyruar në dollarë të Shteteve të Bashkuara në datën e konvertimit në të holla, anëtari i paguan Bankës shumën plotësuese brenda një periudhe prej 7 ditësh nga data e paraqitjes së bankënotës për konvertim në të holla për t'u siguruar se Banka arkëton çmimin e plotë të blerjes së aksioneve të nënshkruara;

e) lidhur me çdo nënshkrim të paraqitur në paragrafin 2, kolonat 1 dhe 2 më sipër, Banka i konsideron të paguara pjesët 2% dhe 18% të nënshkrimeve sipas nenit II, seksioni 7/"i" të statutit, për të cilat nuk kërkohet pagesa sipas paragrafit 3/"c" më sipër vetëm kur nevojitet plotësimi i detyrimeve të Bankës për fonde të marra hua ose për huat e garantuara prej saj dhe jo për përdorim nga Banka për aktivitete huadhënëse ose për shpenzime administrative;

f) para se çdo nënshkrim të pranohet nga Banka, anëtari duhet të ketë:

i) marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të autorizuar një nënshkrim të tillë dhe duhet t'ia mundësojë Bankës një informacion të tillë nëse Banka mund ta kërkojë;

ii) bërë pagesat e përcaktuara në paragrafin 3/"c" dhe "d" më sipër; dhe

iii) marrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar përdorshmërinë e pakufizuar dhe të shpejtë nga Banka në veprimet e saj lidhur me pjesën e çmimit të nënshkrimeve/të aksioneve të paguara në monedhën e anëtarëve sipas nenit II, seksioni 7/"i" të statutit; dhe

g) me nënshkrimin e këtyre aksioneve, anëtari do të konsiderohet të ketë:

i) dhënë pëlqimin e tij të pakthyeshëm të shfrytëzimit të pakufizuar dhe të menjëhershëm të kapitalit të tij të paguar, pavarësisht të drejtave që gëzon anëtari për miratim sipas nenit IV, seksioneve 2/"a" dhe "b" të statutit, të drejtave të tjera sipas nenit V, seksionit 12 të statutit për

të zëvendësuar bankënotat ose obligacionet e ngjashme ose çdo të drejtë tjetër ose kufizime; dhe

ii) pranuar se pjesa e disbursuar e nënshkrimit të tij nevojitet në veprimet e Bankës dhe bankënotat ose obligacionet mund të mos zëvendësohen me valutë e ndonjë anëtari; dhe

h) në rast mosmiratimi të rezolutës për rritjen selektive të kapitalit në apo para datës së miratimit të kësaj rezolute, atëherë Banka nuk pranon nënshkrime para ose më herët, se: i) data e miratimit të rezolutës për rritjen selektive të kapitalit nga Këshilli i Guvernatorëve; dhe ii) data që Banka njofton çdo anëtar se periudha e votimit të rezolutës për rritjen selektive të kapitalit, me gjithë zgjatjet e mundshme, ka përfunduar. Nëse periudha e votimit për rezolutën e rritjes selektive të kapitalit mbyllet pa miratimin e rezolutës për rritjen selektive të kapitalit nga ana e Këshillit të Guvernatorëve, atëherë numri i aksioneve të autorizuara për nënshkrim nga secili anëtar, siç është përcaktuar në paragrafin 2, më sipër, përshtatet në mënyrë të tillë që alokimi në përpjesëtim të drejtë i aksioneve për çdo anëtar pas hyrjes në fuqi të rritjes së kapitalit aksionar sipas kësaj rezolute është e barabartë me alokimin në përpjesëtim të drejtë të aksioneve për anëtarin pa hyrjen në fuqi të rezolutës për rritjen selektive të kapitalit.

4. Të gjitha të drejtat, përfshirë të drejtën e votës, të kërkuara në respekt të aksioneve për të cilat është bërë pagesë me anë të bankënotës, sipas paragrafit 3/"d" më sipër duhet të pezullohet:

a) nëse pagesa nuk është bërë brenda një periudhe prej shtatë ditësh nga paraqitja e saj për t'u kthyer në të holla; dhe

b) nëse, për çdo bankënotë të denominuar në një valutë të ndryshme nga dollari i Shteteve të Bashkuara, kthimi në të holla çon në një humbje të çmimit të blerjes së aksioneve dhe pagesa shtesë nuk bëhet brenda një periudhe prej 7 ditësh të datës përkatëse të pagesës, në secilin rast vetëm për sa u përket aksioneve për të cilat pagesa nuk është arkëtuar dhe derisa pagesa e plotë në të holla të arkëtohet nga Banka.

5. Pas përfundimit të periudhës së nënshkrimit të përcaktuar në paragrafin 3/"b" më sipër:

a) nënshkrimi për çdo aksion, për të cilin janë pezulluar të drejtat në përputhje me paragrafin 4 më sipër, bëhet i pavlefshëm; dhe

b) kapitali aksionar i alokuar Bankës që nuk është nënshkruar, përfshirë të gjitha aksionet për të cilat nënshkrimi është bërë i pavlefshëm sipas paragrafit 6/"a" më sipër, bëhet pjesë e kapitalit aksionar të paalokuar të Bankës.

(Miratuar më 16 mars 2011)